

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

KORRIDORET 8 DHE 10D

A KEMI GARANCI TË MJAFTUESHME QË
NDËRTIMI I AUTOSTRADAVE NUK DO TË
NDIKOJË NEGATIVISHT NË FONDIN PYJOR


TOGETHER IN
**CLIMATE
ACTION**

DOKUMENT PËR POLITIKA PUBLIKE

KORRIDORET 8 DHE 10D

A KEMI GARANCI TË MJAFTUESHME QË NDËRTIMI I AUTOSTRADAVE NUK DO TË NDIKOJË NEGATIVISHT NË FONDIN PYJOR

Botues

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

Autore

Bojana Bozhinovska Siljanovska

Redaktues

Bojan Trpevski dhe Goce Kocevski

Projekti

Organizatata civile në veprim për ndryshimet klimatike

Implementues

Qendra për hulumtim dhe informim për mjedisin jetësor "Eko-vest" nga Shkupi, Shoqata maqedonase e juristëve të rinj (SHMJR) dhe Organizata lidhja e vlerave natyrore dhe njerëzve-CNVP

Redaktimi gjuhësor

Eleonora Stojkoska –Popetrevska

Përkthim nga gjuha maqedonase në shqip nga përkthyesi

Rexhep Xheladini

Dizajn grafik

Haris Muriq

Shkup, 2023



Ky produkt është përgatitur në kuadër të projektit "Organizatata civile në veprim për klimën", mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim– SIDA. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë ato të autorëve të kësaj analize dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e donatorit dhe të Qeverisë së Suedisë.

PËRMBLEDHJE	1
HYRJE	2
METODOLOGJIA	3
MBROJTJA E PYJEVE DHE KORRIDORET 8 DHE 10-D	4
MBROJTJA E PYJEVE NË BE	6
ÇËSHTJA PYLLIT BJALOVIEZHA/BIAŁOWIEŻA (KOMISIONI KUNDËR POLONISË – C-441/17)	7
VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDISIN JETËSOR	10
A DO T'I NËNSHTROHEN KORRIDORET NJË VLERËSIMI TË DETYRUESHËM TË NDIKIMIT TË PROJEKTIT NDAJ MJEDISIT JETËSOR?	12
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	14
LITERATURA E PËRDORUR	15

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE

Më 7 mars 2023, Qeveria RMV-së miratoi kontratën për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d. Grupe deputetësh kanë dorëzuar nëntë propozime për ndryshimin e ligjeve, të cilat sipas arsytimit janë të nevojshme për realizimin e projektit. Ndër të tjera u propozuan ndryshime në Ligjin për Pyjet. Amendamentet e propozuara parashikojnë që procedura për shndërrimin e përhershëm të tokës pyjore nuk do të kryhet kur bëhet fjalë për “ndërtesa me interes strategjik të përcaktuara me ligj”.

Më 8 maj 2023, duke përdorur të ashtuquajturën procedurë të shkurtuar të “flamurit evropian”, qeveria paraqiti propozime për pesë nga ligjet për të cilat tashmë ishin paraqitur propozime nga deputetët. Në mesin e tyre nuk ishte Ligji për Pyjet, edhe pse pjesa e planifikuar nga Gostivari në Bukojçan kryesisht kalon nëpër tokë pyjore dhe do të jetë e nevojshme të pritët pylli.

Ajo që mbetet si garanci se do të merren masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor gjatë përfshirjes së pyjeve është zbatimi i një procedure të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor. Vlerësimi i ndikimit në mjedis jetësor synon të parashikojë ndikimet e mundshme të dëmshme në mjedisin jetësor dhe të shmangë ose reduktojë ndikime të tilla të dëmshme, duke balancuar objektivat mjedisore, sociale dhe ekonomike.

Legjislacioni i Maqedonisë parashikon një procedurë për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor dhe projektet që duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor, i cili është i sinkronizuar me direktivën e Bashkimit Evropian (BE). Ndërtimi i autostradave është i përfshirë në projekte ku vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor është i domosdoshëm dhe i detyrueshëm sipas rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV-së) dhe BE-së. Megjithatë, edhe pse procesi ka filluar, ende nuk ka vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor për pjesën e parë të autostradës Gostivar-Bukojçan, ku ka një shtrirje pyjore.

Në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian është duke u zhvilluar një rast për të cilin tashmë është dhënë aktgjykimi i parë, të cilit i ka paraprirë një masë e përkohshme, e cila parashikon ndalimin e prerjeve dhe gjoba prej 100.000 euro në ditë. Është një rast i një rëndësie të veçantë dhe precedent në fushën e së drejtës mjedisit jetësor dhe mbrojtjes së pyjeve. Sipas Gjykatës, “autorizimi për një plan ose projekt mund të jepet vetëm me kushtin që autoritetet kompetente të jenë të bindura se plani ose projekti nuk do të ketë efekte negative të qëndrueshme në integritetin e zonës në fjalë. Është një rast kur nuk ka dyshim të arsyeshëm shkencor për mungesën e efekteve të tilla.

Prandaj, theksohet si vijon: Realizimi efektiv i projekteve strategjike nuk duhet të nënkuptojë efekt negativ në mjedisin jetësor dhe ekzistencën e pasigurisë ligjore!

HYRJE

Pyjet janë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien tonë, si dhe për mbrojtjen e mjedisit jetësor në përgjithësi. Ata kanë një biodiversitet të pasur (80% e biodiversitetit në botë gjendet në zonat pyjore)¹ dhe kanë një rëndësi të madhe në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Ata na ofrojnë ujë të pastër, ushqim, ilaçe dhe furnizime (25% e njerëzve varen nga pyjet për jetesën dhe të ardhurat),² ato zvogëlojnë rrezikun e fatkeqësive dhe stabilizojnë tokën.

Evropa është një nga rajonet pyjore më të pasura në botë (45% e tokës së Evropës është e mbuluar nga pyjet).³ Megjithatë, praktikat aktuale të menaxhimit të pyjeve nuk janë gjithmonë në përputhje me nevojën për të siguruar biodiversitet të lartë në ekosistemet pyjore. Me kërkesën gjithnjë në rritje për lëndë drusore, pyjet dhe ekosistemet e tyre vazhdojnë të vuajnë nga ndotja e ajrit dhe ujit, humbja e habitatit dhe biodiversitetit, si dhe prekja e zonave urbane.⁴

Kushtet natyrore në RMV, të përcaktuara nga vendndodhja, klima, relievi, ndërtimi pedologo-gjeologjik i terrenit si dhe karakteristikat hidrologjike-hidrografike mundësojnë mbijetesën dhe zhvillimin e një numri të madh të llojeve bimore dhe shtazore. Prandaj, vendi ynë llogaritet ndër vendet me biodiversitet të pasur. Një numër i madh i specieve bimore dhe shtazore janë relikte dhe endemike.⁵

Për shkak të këtyre funksioneve publike, pyjet janë pjesë e pasurisë kombëtare. Pyjet janë të mbrojtura edhe me Kushtetutë. Neni 56 i Kushtetutës së RMV-së thotë: "Të gjitha pasuritë natyrore të Republikës, bota bimore dhe shtazore, të mirat në përdorim të përgjithshëm, si dhe sendet dhe objektet me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike të përcaktuara me ligj, janë të mira me interes të përgjithshëm për Republikën dhe gëzojnë mbrojtje të veçantë".

¹ European Commission, Forests

² Ibid

³ Ibid

⁴ Ibid

⁵ Pyjet nacionale, Pyjet në RMV

METODOLOGJIA

Rasti i menjëhershëm që imponoi nevojën e këtij dokumenti ishte projekti i paralajmëruar për ndërtimin e autostradave në korridoret 8 dhe 10d, të cilat në një pjesë të caktuar duhet të kalojnë edhe nëpër pyje. Dokumenti përmban një analizë ligjore të implikimeve të ndryshimeve të propozuara në kuadrin ligjor të nevojshëm për realizimin e projektit përmes prizmit të mbrojtjes së mjedisit jetësor. Për më tepër, dokumenti identifikon dhe tregon standardet e të drejtës së BE-së si dhe praktikën e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së në lidhje me mbrojtjen e pyjeve. Në bazë të analizës, dokumenti propozon rekomandime për promovimin e politikave që do të mundësojnë ndërtimin e autostradave me ndikim minimal në pyje dhe mjedisin jetësor. Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti është bërë hulumtimi nga zyra dhe janë analizuar rregulloret përkatëse, raportet dhe aktet tjera.

MBROJTJA E PYJEVE DHE KORRIDORET 8 DHE 10-D

Kuvendi i RMV-së në vitin 2021 me ligj⁶ përcaktoi rëndësinë strategjike nacionale të ndërtimit të korridoreve 8 dhe 10d.⁷ Ligji e përcaktoi konsorciumin Bechtel and Enka JV të realizojë projektin dhe të autorizojë Qeverinë për të udhëhequr procesin e lidhjes së kontratës së ndërtimit. Ligji lejon konsorciumin të zbatojë "*proces unik të ndërtimit të Projektit përmes një metode të shpejtë të planifikimit, ekzekutimit dhe ndërtimit*". Kjo në mënyrë implicite lë të kuptohet për një trajtim preferencial të partnerit strategjik pa rregulluar se si do të kryhet "procesi unik i ndërtimit", duke marrë parasysh ligjet ekzistuese.

Më 7 mars 2023, qeveria RMV-së miratoi kontratën për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d. Marrëveshja dhe veçanërisht detyrimet që ka marrë shteti nuk u bënë publike për një sërë arsyesh kontradiktore, që nga fakti se është informacion i klasifikuar e deri sekret biznesi. Detyrimet e shtetit u bënë të njohura deri diku më 04.03.2023 kur grupe deputetësh paraqitën nëntë propozime për ndryshimin e ligjeve,⁸ të cilat sipas arsyetimit janë të nevojshme për realizimin e projektit.

Ndër të tjera u propozuan ndryshime në Ligjin për Pyjet. Amendamentet e propozuara parashikojnë që procedura për konvertimin e përhershëm të tokës pyjore nuk do të kryhet kur bëhet fjalë për "*për ndërtesat me interes strategjik të përcaktuara me ligj*".⁹ Sipas Ligjit për Pyjet, shndërrimi i përhershëm bëhet për ndërtimin e objekteve me interes publik si dhe për kryerjen e punëve me interes publik të përcaktuara me ligj.¹⁰ Mirëpo, procedura për shndërrim të përhershëm nuk kryhet për shkak të zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe urbanistik, përfshirë Planin Hapësinor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Planin Hapësinor për Rajonin dhe Planin Hapësinor për Zonën me interes të veçantë për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Sipas Planit Hapësinor për periudhën 2004-2020, pjesa nga Gostivari deri në Kërçovë është planifikuar për autostradë, ndërsa pjesa nga Prilepi deri në Manastir si rrugë kryesore.¹¹

Propozimet hasën në reagime dhe rezistencë serioze të qytetarët dhe opinionit profesional. Argumentet kryesore që u theksuan ishin se po vendoset një regjim i dyfishtë juridik, po cenohet shteti i së drejtës dhe po rrezikohet mbrojtja e të drejtave të punës dhe mjedisit jetësor. Prandaj, procedura sipas këtyre propozimeve është ndërprerë në Kuvend dhe trupa punues.

⁶ Ligji për përcaktimin e interesit publik dhe emërimin e partnerit strategjik për realizimin e projektit për ndërtimin e korridorit infrastrukturor 8 (seksioni: Tetovë - Gostivar - Bukoçan dhe projekti për autostradën Trebenishtë - Strugë - Qafë Thanë) dhe korridori 10 d (seksioni të autostradës Prilep - Manastir)) në Republikën e Maqedonisë së Veriut. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 163/2021.

⁷ Termat Korridori 8 dhe Korridori 10d sipas këtij ligji i referohen seksioneve të veçanta dhe Korridori 8 i referohet pjesëve: Tetovë - Gostivar - Bukoçan dhe autostrada Trebenishtë - Strugë - Qafë Thanë, ndërsa Korridori 10d i referohet Prilep - Manastir.

⁸ Është punuar në projektligjet për ndryshime dhe shtesa në ligjet për: ndërtim, urbanistik, tokë bujqësore, pyje, marrëdhënie të punës, pasuri minerale, shpronësim, trashëgimi kulturore, si dhe ligjin bazë për përcaktimin e interesit strategjik dhe emërimin e partnerit strategjik.

⁹ Propozim Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për pyjet, pas procedurës së shkurtuar, prill 2023, nenet 1 dhe 2.

¹⁰ Ligji për pyjet, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2009, 24/2011, 53/2011, 25/2013, 79/2013, 147/2013, 43/2014, 160/2014, 33/2015, 44/2015, 147/2015, 7/2016 dhe 39/2016 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 274/2022, neni 14 paragrafi 2.

¹¹ Plani hapësinor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2004 – 2020). Harta nr. 13.

Me qëllim të ndalimit të procedurës, Qeveria më 08.05.2023 duke përdorur të ashtuquajturën procedurë e shkurtuar me "flamur evropian" paraqiti propozime për pesë¹² ligje për të cilat tashmë janë paraqitur propozime nga deputetët. Propozimet ishin më të sakta, por thelbi i reformave ishte i njëjtë, vendosja e një regjimi të posaçëm ligjor në të cilin procedurat ekzistuese do të përshpejtohen ose anashkalohen ndjeshëm. Procedura me flamurin evropian për shkak të afateve të kufizuara për diskutim dhe mundësi për amendamente lejoi që këto pesë projektligje të miratohen.

Ligji për pyjet nuk ishte në mesin e tyre, edhe pse pjesa e planifikuar nga Gostivari në Bukojçan kryesisht kalon nëpër tokë pyjore dhe do të duhet të pritet.¹³ Prandaj, shtrohet pyetja nëse Qeveria do të paraqesë propozim të veçantë për ndryshime në Ligjin për pyjet, nëse procedura do të vazhdojë sipas propozimit të deputetëve apo mund të mos ketë fare ndryshime në Ligjin për Pyje. Ajo që mund të supozohet në këtë fazë, duke marrë parasysh të dhënat në dispozicion (të kufizuara), është se përshkimi i pyjeve do të kryhet pa procedurë konvertimi, duke iu referuar arsyesimit që projekti zbaton Planin Hapësinor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

¹² Ndërtimi, planifikimi urbanistik, marrëdhëniet e punës, shpronësimet dhe ligji bazë për përcaktimin e interesit strategjik dhe emërimin e partnerit strategjik.

¹³ NPRRSH. Njoftim për synimin për ndërtimin e autostradës A2, seksioni Gostivar - Kërçovë, gusht, 2015, faqe 24.

MBROJTJA E PYJEVE NË BE

BE-ja ndan disa kompetenca të lidhura me pyjet me shtetet anëtare, duke përfshirë mjedisin jetësor, klimën dhe bujqësinë. Gjatë ushtrimit të këtyre kompetencave, Bashkimi Evropian respekton parimin e subsidiaritetit. Në veçanti, mbrojtja e pyjeve është një pjesë thelbësore e aktiviteteve të mjedisit jetësor të BE-së dhe kompetencës së BE-së bazuar në nenet 191-192 të Traktatit për Funksonimin e BE-së, siç konfirmohet nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë.

Megjithëse nuk ka "politikë të përbashkët pyjore", pyjet në nivel të BE-së rregullohen nga disa instrumente ligjore: Strategjia e BE-së për Pyjet për vitin 2030; Direktiva 1999/105/EC për reklamimin e materialit riprodhues pyjor; Rregullorja (KE) nr. 1698/2005 për mbështetjen e zhvillimit rural; Rregullorja (KE) nr. 2152/2003 lidhur me monitorimin e pyjeve dhe ndërveprimet me mjedisin në Komunitetin [Evropian]; Direktiva 2000/29/KE për masat mbrojtëse kundër shfaqjes së organizmave të dëmshëm për bimët dhe produktet e tyre dhe kundër përhapjes së tyre brenda Komunitetit [Evropian]; Rregullorja (KE) nr. 2173/2005 për krijimin e skemës së licencimit FLEGT për importin e lëndës drusore në Komunitetin Evropian; Rregullorja (KE) nr. 1024/2008 për vendosjen e rregullave të detajuara për zbatimin e Rregullores (KE) nr. 2173/2005; Rregullorja (KE) nr. 995/2010 për vendosjen e detyrimeve për operatorët që plasojnë dru dhe produkte druri në treg.¹⁴

Strategjia e BE-së për Pyjet 2030 është një nga nismat kryesore të Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane. Strategjia përcakton një vizion dhe veprime konkrete për të përmirësuar sasinë dhe cilësinë e pyjeve të BE-së dhe për të forcuar mbrojtjen, restaurimin dhe rezistencës/elasticitetin e tyre. Ajo synon të përshtatë pyjet evropiane me kushtet e reja, ekstremet e motit dhe pasigurinë e lartë të shkaktuar nga ndryshimet klimatike.¹⁵

Mbrojtja e mjedisit është e kodifikuar në nenin 37 të Kartës së të Drejtave Themelore të Njeriut të Bashkimit Evropian dhe thotë: "Në politikat e Bashkimit, një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit natyror dhe përmirësimi i cilësisë së tij duhet të integrohet dhe sigurohet në përputhje me parimin e zhvillimit të qëndrueshëm". Me këtë nen, mbrojtja e mjedisit jetësor praktikisht fitoi rëndësi për të drejtat e njeriut në kontekstin ligjor të BE-së.¹⁶

¹⁴ Ministria Federale e Bujqësisë, Pylltarisë, Rajoneve dhe Menaxhimit të Ujërave të Republikës së Austrisë, E Drejta për Pyje – Bashkimi Evropian dhe E Drejta Ndërkombëtare

¹⁵ European Commission, Forests

¹⁶ Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian

ÇËSHTJA PYLLIT BJALOVIEZHA/BIAŁOWIEŻA (KOMISIONI KUNDËR POLONISË – C-441/17)

Pylli Bjaloviezha është vend i mbrojtur, vend i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s dhe përfaqëson një nga pyjet e fundit primare në Evropë. Në vitin 2012, Polonia miratoi një plan të menaxhimit të pyjeve për periudhën 2012-2021, në vitin 2015 miratoi një plan menaxhimi që përcaktonte masat dhe objektivat e ruajtjes së pyllit, si dhe në mars 2016, autoritetet polake miratuan një vendim për të ndryshuar planin e vitit 2012, i cili lejon një rritje të trefishtë të operacioneve të prerjes së pyjeve në rrethin e tij, si dhe prerjet në zona të përjashtuara deri më tani nga çdo ndërhyrje. Arsyetimi për vendimin e vitit 2016 ishte mbrojtja nga dëmtimi i pyllit si pasojë e përhapjes së brumbujve të lëvores së bredhit (*spruce bark beetle*). Për të gjitha dokumentet, përveç vendimit të vitit 2016, është bërë vlerësimi i ndikimit ndaj mjedisit jetësor.¹⁷

PSE RASTI I BIAŁOWIEŻA ËSHTË I RËNDËSISHËM GJATË NDËRTIMIT TË AUTOSTRADËS NGA KORRIDORI 8?

- Aktivitetet për ndërtimin e Korridorit 8 zhvillohen në natyrë, në kuptim të përcaktimit të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës. Ashtu si në rastin e Białowieża, aktivitetet për ndërtimin e Korridorit 8 përfshijnë prerjen e pyjeve.
- Gjykata e Drejtësisë së BE-së jep udhëzime dhe vendos standarde për cilësinë e vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor.
- Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor është i detyrueshëm sipas Ligjit për Mjedisin Jetësor dhe Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, si dhe përmendet edhe në përkufizimet e Ligjit për Pyjet.
- Standardet e GJDBE-së për cilësinë e vlerësimit të ndikimit në mjedis janë pjesë e Acquis Communitar të BE-së, rrjedhimisht ato janë të zbatueshme dhe relevante për Maqedoninë e Veriut e cila pret të fillojë negociatat e anëtarësimit.
- Vendimi në çështjen Białowieża thekson analizën e efektit kumulativ që mund të kenë projektet e tjera në zonat e mbrojtura, edhe pse ato nuk lidhen drejtpërdrejt me to. Në afërsi të itinerarit nga Korridori 8 ndodhet Parku Kombëtar i Mavrovës dhe vetë traseja i afrohet shpellës Bukuroshes/Ubavicës, e cila mbrohet si monument natyre,¹⁸ prandaj theksohet nevoja për të ndjekur standardet e BE-së gjatë krijimit të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor.
- Vendimi i GJDBE-së jep udhëzime për mënyrën se si duhet të interpretohen dispozitat për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit vis a vis nevojave ekonomike, sociale dhe kulturore të shtetit.

¹⁷ Shih në detaje paragrafët 16-53 të Aktgjykimit të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, C-441/17, Komisioni kundër Polonisë, datë 17.04.2018.

¹⁸ NPPRRSH. Njoftimi për qëllimin për ndërtimin e autostradës A2, pjesa Gostivar-Kërçovë, gusht 2015, faqe 13.

Si pjesë e procedurës për shkelje të ligjit të BE-së, Komisioni Evropian në vitin 2017 nisi një procedurë kundër Polonisë para Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE-së). Më 17.04.2018, Këshilli i Madh i GJDBE-së miratoi një rezolutë që përcaktonte se Polonia shkeli dispozitat e direktivave që përgjithësisht i referohen mbrojtjes së habitateve dhe mbrojtjes së shpendëve.¹⁹

Sipas GJDBE-së "autorizimi për një plan ose projekt mund të jepet vetëm me kushtin që autoritetet kompetente të jenë të bindura se plani ose projekti nuk do të ketë efekte të përhershme negative në integritetin e vendndodhjes në fjalë. Është një rast kur nuk ka dyshim të arsyeshëm shkencor për mungesën e efekteve të tilla. Autoritetet shtetërore kompetente nuk mund të miratojnë ndërhyrjet kur ekziston rreziku i dëmtimit të përhershëm të veçorive ekologjike të vendeve që strehojnë lloje të habitateve natyrore me interes ose prioritet të Komunitetit. Kjo do të vrente veçanërisht në rastet kur ekziston rreziku që ndërhyrja të çojë në zhdukjen ose shkatërrimin e pjesëshëm dhe të pariparueshëm të një lloji të tillë habitati natyror në vendndodhjen e prekur."²⁰

Duke shqyrtuar rastin konkret, GJDBE referoi në mënyrë specifike dhe vuri në dukje se "vlerësimi i ndikimeve të planit ose projektit që nuk lidhen drejtpërdrejt ose nuk janë të nevojshëm për menaxhimin e zonës së prekur, duhet të marrë parasysh edhe efektin kumulativ që rezulton nga ai plan apo projekt, në kombinim me plane dhe projekte të tjera dhe në drejtim të synimeve të përcaktuara të ruajtjes për atë zonë".²¹ GJDBE-ja, duke marrë parasysh se autoritetet polake në kohën kur morën vendimin nga viti 2016, ata ende nuk kishin rezultatet e anketimit në lidhje me biodiversitetin e zonës, treguan se vlerësimi nuk mund të konsiderohet si adekuat, në kuptimin të kuptimit të fjalisë së parë të nenit 6 (3) të Direktivës së Habitaveve, në një situatë ku mungojnë të dhënat e përditësuara për habitatet dhe speciet e mbrojtura. Meqenëse autoritetet polake e dinin se të dhënat që kishin në dispozicion kur morën vendimin në 2016 ishin të pamjaftueshme, ato nuk mund të konsiderohen se kanë kryer një vlerësim adekuat të ndikimit.²² Në të njëjtën kohë, "vlerësimi i duhur i ndikimeve të planit ose projektit për zonën e prekur duhet të jetë kryer përpara miratimit të tij, kështu që vlerësimi nuk mund të bëhet paralelisht ose pas miratimit".²³

"Vendimi tregon se Komisioni Evropian, në dritën e parimit të kujdesit, i cili është i integruar në dispozitën në nenin 6(3) të Direktivës 92/43 për ruajtjen e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër, të ndryshuar me Direktivën 2013/17, "nuk duhet të provojë një lidhje shkakësore midis operacioneve në fjalë dhe efektit negativ në integritetin e habitateve dhe specieveve, mjafton të vërtetohet ekzistenca e një probabiliteti ose rreziku që këto operacione mund të çojnë në një efekt të tillë".²⁴

Sipas Gjykatës, argumenti i Polonisë se "Pylli Białowieża nuk mund të konsiderohet një pyll 'natyror' ose 'primar' sepse ai ka qenë gjithmonë subjekt i shfrytëzimit aktiv njerëzor nëpërmjet të cilit përcaktohen karakteristikat e tij është i parëndësishëm" sepse pavarësisht nga klasifikimi i pyllit specifik, Direktiva për Habitatet dhe Zogjtë përcaktojnë kuadrin për menaxhimin e pyjeve.²⁵

¹⁹ Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, C-441/17, Komisioni kundër Polonisë i datës 17 prill 2018 (Białowieża), paragrafi 268. Dëshmtimi i një shteti Anëtar për të përmbushur detyrimet e tij – Mjedisjetësor - Direktiva 4 dhe 592/43/EE3 - Ruajtja e habitateve natyrore dhe faunës dhe florës së egër – Neni 6(1) dhe (3) – neni 12(1) – Direktiva 2009/147/EE3 – Ruajtja e zogjve të egër – nenet 4 dhe 5 – „Puszcza Białowieża” Lokacioni Natura 2000 – Ndryshimi i planit të menaxhimit të pyjeve - Rrija e vëllimit të lëndës drusore të korrur - Plani ose projekti nuk kërkohet drejtpërdrejt për menaxhimin e zonës, i cili ka të ngjarë të ketë një efekt të rëndësishëm në të - Vlerësimi adekuat i implikimeve për vendin - Ndikimi negativ në integritetin e zonës - Zbatimi aktual i masave mbrojtëse - Efektet në vendet e shumimit dhe vendet e pushimit të specieveve të mbrojtura.

²⁰ Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, Raporti i GJED-së mbi aktgjykimin në çështjen C-441/17, Komisioni kundër Polonisë.

²¹ Aktgjykimin i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, C-441/17, Komisioni kundër Polonisë, datë 17.8.2018, paragrafi 135.

²² Ibid, paragrafi 135, 149, 150.

²³ Ibid, paragrafi 148.

²⁴ Ibid, paragrafi 158.

²⁵ Ibid, paragrafi 155.

Duke trajtuar argumentin e Polonisë se neni 6(4) i Direktivës së Habitaveve thotë se promovimi i biodiversitetit kryhet duke marrë parasysh nevojat ekonomike, sociale, kulturore dhe rajonale, GJED-ja nënvizoi ndër të tjera se "edhe kur ka një vlerësim negativ dhe projekti ose plani duhet të zbatohet për shkak të një interesi publik mbizotërues, duke përfshirë atë të natyrës sociale ose ekonomike dhe në mungesë të zgjidhjeve alternative, shtetet anëtare duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme kompensuese për të siguruar që koherenca e përgjithshme e Natura 2000 të jetë e mbrojtur".²⁶

Neni 6(1) i Direktivës 92/43 për ruajtjen e habitaveve natyrore dhe faunës dhe florës së egër, i ndryshuar nga Direktiva 2013/17 dhe neni 4 pika 1 dhe 2 e Direktivës 2009/147 për ruajtjen e zogjve të egër të ndryshuar me Direktivën 2013/17, kërkojnë që masat e ruajtjes të nevojshme për të mbajtur një status të favorshëm ruajtjeje të habitaveve dhe specieve të mbrojtura brenda vendndodhjes përkatëse jo vetëm të miratohen, por mbi të gjitha të zbatohen në të vërtetë.²⁷ Duke përsëritur këtë pikë, GJED-ja thekson se "Neni 12(1)(d) i Direktivës së Habitaveve parashikon një regjim për mbrojtjen e rreptë të vendeve të shumimit dhe vendeve të pushimit të specieve të listuara në *Aneksin IV(a) të Direktivës, pavarësisht nga numri [i specieveve të tilla]*".²⁸

Aktgjykimi thekson gjithashtu se në përputhje me nenin 12(1)(a) dhe (d) të Direktivës 92/43 për ruajtjen e habitaveve natyrore dhe faunës dhe florës së egër dhe nenit 5 të Direktivës 2009/147 për ruajtjen e zogjve të egër, të ndryshuar me Direktivën 2013/17, shtetet anëtare jo vetëm që janë të detyruara të nxjerrin legjislacion gjithëpërfshirës të plotë dhe efektiv, por janë të detyruara edhe të marrin masa mbrojtëse. Në mënyrë të ngjashme, sistemi i mbrojtjes strikte supozon miratimin e masave koherente dhe të koordinuara të një natyre parandaluese. Prandaj, një sistem i tillë mbrojtjeje të rreptë duhet të lejojë shmangien reale të kapjes ose vrasjes së qëllimshme në natyrë dhe përkeqësimin ose shkatërrimin e vendeve të shumimit ose të vendeve të pushimit, të llojeve të kafshëve dhe shpendëve.

²⁶ Ibid, paragrafi 188-190.

²⁷ Ibid, paragrafi 213, 214, 218.

²⁸ Ibid, paragrafi 237.

VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDISIN JETËSOR

Kreu XI i Ligjit për Mjedisin Jetësor përcakton procedurën për vlerësimin e ndikimit në mjedisin jetësor. Një vlerësim i ndikimit të mjedisit jetësor synon të parashikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore dhe të shmangë ose reduktojë ndikime të tilla negative, duke balancuar objektivat mjedisore, sociale dhe ekonomike. Gjatë kryerjes së vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor, duhet të merren gjithmonë parasysh masat për të parandaluar, kufizuar, zbutur ose reduktuar ndikimet e dëmshme dhe duhet të jepet një vlerësim i efekteve të masave të propozuara. Dhe nuk është më pak e rëndësishme që gjithmonë të jetë e mundur të bëhet një propozim për vendndodhje të tjera alternative për ekzekutimin e projektit, në mënyrë që të zvogëlohet ndikimi i dëmshëm në mjedisin jetësor.²⁹

Direktiva e BE-së për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedisin Jetësor synon të sigurojë që projektet që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në mjedisin jetësor janë identifikuar dhe vlerësuar, si pjesë e procesit të vlerësimit, përpara se këto projekte të vazhdojnë me zhvillimin.

Ky vlerësim përfshin një përshkrim të projektit, duke përfshirë një vlerësim, sipas llojit dhe sasisë, të mbetjeve dhe emetimeve të pritura (ndotja e ujit, ajrit dhe tokës, zhurma, dridhja, drita, nxehtësia, rrezatimi, etj.) që rezultojnë nga zbatimi i projektit të propozuar.

Projektet e renditura në Aneksin 1 të Direktivës vlerësohen se kanë ndikime të rëndësishme në mjedisin jetësor dhe për këtë arsye kërkohet t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndikimit mjedisit jetësor. Aneksi 2 tregon projektet ku vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor është zgjedhore.

Ndërtimi i autostradave dhe rrugëve të shpejta renditet gjithashtu në projektet që duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi të ndikimit në mjedisin jetësor të renditur në Aneksin 1 të kësaj Direktive.³⁰

Në bazë të nenit 77 të Ligjit për Mjedisin Jetësor, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka miratuar Dekretin për përcaktimin e projekteve dhe për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet nevoja për zbatimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor.³¹

²⁹ Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedisin Jetësor.

³⁰ Direktiva e BE-së 2011/92, aneksi 1 pika 7(b).

³¹ Dekreti për përcaktimin e projekteve dhe për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet nevoja për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ndikimeve në mjedis, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74/2005, 109/2009, 164/2012 dhe 202/2016 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.175/2022.

Dekreti është i sinkronizuar me Direktivën e BE-së dhe i njëjti në Aneksin 1, pika 7(b) përfshin ndërtimin e autostradave si përveç kësaj, Maqedonia e Veriut është nënshkruese e Konventës për qasje në informacion, pjesëmarrje publike në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi për çështjet e mjedisit jetësor të Kombeve të Bashkuara.³² Neni 6 i Konventës flet për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen e aktiviteteve specifike, ndër të cilat projektet për ndërtimin e autostradave renditen në aneksin 1. Neni 6, pika 6 tregon se sa vijon duhet të jetë në dispozicion të publikut: (a) Përshkrimi i vendit të zbatimit dhe veçorive fizike dhe teknike të aktivitetit të propozuar, si dhe një vlerësim i mbetjeve dhe emetimeve të pritshme; (b) Përshkrimi i ndikimeve të rëndësishme në mjedisin jetësor të aktivitetit të propozuar; (c) Përshkrimi i masave të parashikuara për të parandaluar dhe/ose reduktuar pasojat, duke përfshirë emetimet; (ç) Një përmbledhje jo-teknike e sa më sipër; (e) Një përmbledhje e alternativave parësore të studiuara nga kandidati. Sipas kësaj, jo vetëm zhvilluesi i projektit të ndërtimit të autostradës është i detyruar të paraqesë një raport të ndikimit në mjedisin jetësor, por edhe publiku duhet të njoftohet për të. Anëtari merr masa që publikut t'i jepet një përgjigje e duhur me shkrim dhe një bisedë me kandidatin dhe më tej në vendim duhet të merret parasysh rezultati i pjesëmarrjes së publikut dhe publiku duhet të informohet për vendimin.

Përveç kësaj, ky dokument i politikave publike specifikon nevojën për të praktikuar të drejtën e sinkronizuar me BE-në dhe respektimin e saj, përndryshe RMV-ja si një vend në negociatë për kandidat në BE do të kishte një përgjegjësi indirekte.

Gjithashtu duhet përmendur se përveç rregullimeve juridike dhe aspektit juridik ndërkom-bëtar Kushtetuta e Maqedonisë së Veriut, në nenin 55, përcakton se Liria e tregut dhe e sipërmarrësisë mund të kufizohen me ligj vetëm me qëllim të mbrojtjes së Republikës, ruajtjes së natyrës, mjedisit jetësor ose shëndetit të njerëzve.

Megjithëse adresimi i efekteve të ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor ka përparësi ndaj veprimeve parandaluese, ka shembuj të praktikave të mira në përfshirjen e qëndrueshmërisë së infrastrukturës rrugore dhe hekurudhore në projektet kapitale të RMV-së. Për ndërtimin e disa pjesëve të autostradës mes Shkupit dhe Kosovës, Vlerësimi ndaj ndikimit mjedisit jetësor dhe aspektet sociale (VNMJAS), dha sugjerime se si rruga duhet të jetë rezistente ndaj ndryshimeve klimatike. Masat e propozuara duhet të përfshihen në projektin kryesor, kështu që kontraktori do të duhet t'i zbatojë ato gjatë ndërtimit. Ky është një shembull tjetër i një praktike të tillë, përveç Studimit të VNMJAS-së për autostradën Bukojčan-Kërçovë, studimin e VNMJAS-së për rrugën shtetërore A3: seksioni Manastir-kalimi kufitar Mexhitlia, pastaj për rrugën shtetërore Strumicë-Valandovë: kryqëzimi me A1. Në transportin hekurudhor mund të përmendim Studimin e VNMJAS-së për ndërtimin e hekurudhës së re në seksionin Kriva Pallankë – Kufiri me Republikën e Bullgarisë, si pjesë e Korridorit 8. Në të gjitha këto studime, planifikuesve të projektit bazë u rekomandohet të përdorin udhëzimet e zhvilluara dhe nëse është e përshtatshme, të zbatojnë disa nga rekomandimet dhe masat për të reduktuar ndikimet negative në mjedisin jetësor nga ndryshimet klimatike. Pra, tashmë ka praktikë pozitive në aplikimin e udhëzimeve për projektimin e infrastrukturës rezistente ndaj klimës, të hartuara për Ndërmarrjen Publike Rrugët Shtetërore.³³

³² Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi në Çështjet Mjedisore.

³³ Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, Analizë e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RMV nga perspektiva e ndikimit në ndryshimet klimatike.

A DO T'I NËNSHTROHEN KORRIDORET

NJË VLERËSIMI TË DETYRUESHËM TË NDIKIMIT

TË PROJEKTIT NDAJ MJEDISIT JETËSOR?

Ajo që mbetet si garanci se do të merren masa për mbrojtjen e mjedisit jetësor gjatë përshkimit të pyjeve është zbatimi i një procedure të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor. Kjo procedurë është e detyrueshme kur kemi të bëjmë me autostrada.³⁴ Megjithatë, është e rëndësishme të merren parasysh ndryshimet në Ligjin për Planifikim Urban dhe Ligjin për Ndërtimet për të përcaktuar se detyrimi për zbatimin e këtij procesi nuk është i përjashtuar.

Me ndryshimet e miratuara në Ligjin për Planifikimin Urban u krijua mundësia e planifikimit të objekteve me interes strategjik me projekt urbanistik për objektet me interes strategjik, pa pasur plan urbanistik për zonat dhe objektet me rëndësi shtetërore.³⁵ Projekti duhet të zhvillohet në bazë të kushteve të planifikimit hapësinor të nxjerra nga Agjencia e Planifikimit Hapësinor, e cila do të mundësojë pajtueshmërinë me Planin Hapësinor të Republikës.

Ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Ndërtim vendosën një "procedurë të përshpejtuar" për ndërtim në një mënyrë që përjashtoi zbatimin e një numri më të madh të dispozitave të ligjit kur kemi të bëjmë me një projekt me interes strategjik. Nga analiza e ndryshimeve, mund të konkludohet se zbatimi i dispozitës që kërkon që projekti i infrastrukturës të përfshijë një studim për vlerësimin e ndikimit të projektit në mjedisin jetësor, nëse rregulloret mjedisore parashikojnë përgatitjen e një studimi, nuk përjashtohet.³⁶

Sa i përket segmentit Gostivar – Bukojçan, në vitin 2015 është paralajmëruar synimi për ndërtimin e autostradës A2, pjesa Gostivar – Kërçovë.³⁷ Për pjesën e dytë të këtij seksioni, nga Bukojçani në Kërçovë, tashmë ka përfunduar procesi i vlerësimit të ndikimit.³⁸ Në procedurën e vlerësimit të ndikimit për segmentin Bukojçan-Kërçovë në vitin 2018, është shpallur një synim i ri,³⁹ mbi bazën e të cilit MMJPH-ja ka nxjerrë vendimin për objektin e studimit të vlerësimit të ndikimit në mjedisin jetësor⁴⁰ duke mos përmendur synimin e vitit 2015.

³⁴ Ligji për mjedisin jetësor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2005; 81/2005; 24/2007; 159/2008; 83/2009; 48/2010; 124/2010; 51/2011; 123/2012; 93/2013; 187/2013; 42/2014; 44/2015; 129/2015; 192/2015; 39/2016 dhe 99/2018 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 89/2022 dhe 171/2022, neni 77 dhe Dekreti për përcaktimin e projekteve dhe për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet nevoja për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ndikimeve në mjedis jetësor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74/2005, 109/2009, 164/2012 dhe 202/2016 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 175/2022, Aneks 1.

³⁵ Ligji për planifikim urbanistik, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 111/2023, neni 63-a.

³⁶ Ligji për Ndërtim, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 111/2023, neni 45-a.

³⁷ NPPRRSH, Njoftimi për synimin për përgatitjen e dokumentacionit të projektit në nivel të projektit të infrastrukturës për rrugën shtetërore A2 seksioni Gostivar - Kërçovë, gusht, 2015. <https://www.mpph.gov.mk/wp-content/uploads/2016/08/A2-seksioni-Gostivar-Kercove-gusht-2015-Kicevo.pdf> - NPPRRSH, Njoftim për synimin për ndërtimin e autostradës A2, seksioni Gostivar - Kërçovë, gusht, 2015.

³⁸ <https://www.mpph.gov.mk/wp-content/uploads/2018/04/Izvestuvanje-za-namera-del-Bukojcani-Final.pdf> - NPPRRSH, Autostrada A2: Seksioni Bukojçan - Kërçovë: Studim i vlerësimit të ndikimit në mjedis jetësor, prill 2018.

³⁹ NPPRRSH, Njoftimi për synimin për përgatitjen e dokumentacionit të projektit në nivel të projektit të infrastrukturës për rrugën shtetërore A2 seksioni Bukojçan-Kërçovë (varianti me tunel), prill 2018.

⁴⁰ MMJPH, Vendimi nr. 11-2875/2 për përcaktimin e nevojës për vlerësimin e ndikimit në mjedis jetësor, dhjetor 2018.

Mbetet e paqartë, duke pasur parasysh se ekziston detyrimi ligjor, qartësia dhe saktësia e pamjaftueshme e dispozitave të Ligjit për Mjedisin Jetësor, por edhe se për nenin e dytë është shpallur një synim i ri posaçërisht për atë seksion, madje nëse procesi është filluar edhe vlerësimi i ndikimit për pjesën Gostivar-Bukojçani, gjegjësisht nëse konsiderohet se ka filluar procedura, pse nuk është bërë procedura për pjesën e parë të kësaj autostrade, për të cilën janë miratuar ligjet e veçanta. Zbatimi konsekuent dhe i plotë i këtij detyrimi është i nevojshëm në mënyrë që shteti të japë garanci që fondi pyjor dhe veçanërisht jeta e kafshëve dhe bimëve nuk do të shkatërrohen në mënyrë të pakthyeshme nga ndërtimi i autostradave.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- › Vlerësimi i ndikimeve ndaj natyrës gjatë ndërtimit të autostradave është i detyrueshëm dhe nuk duhet të lihet të bëhet vetëm për shkak të natyrës strategjike të zbatimit të projektit.
- › Vlerësimi i ndikimit në mjedisin jetësor gjatë ndërtimit të autostradave duhet të përmbajë propozime se si rruga duhet të jetë rezistente ndaj ndryshimeve klimatike. Ky nuk është vetëm një rregull i pranuar në vendet e zhvilluara, por është edhe një praktikë e ndërmarrë gjatë ndërtimit të disa prej autostradave tona. Një projekt i tillë i detajuar me një vlerësim të ndikimit në mjedisin jetësor, duke marrë parasysh ndryshimet klimatike duhet të jetë aty për çdo ndërtim autostradash.
- › Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të respektojë ligjet dhe rregulloret e tjera dhe nuk duhet të lejojë ndryshimin e tyre të nënkuptojë një ndikim të përhershëm të dëmshëm në mjedisin jetësor. Ndërtimi i shpejtë i autostradave dhe ndryshimi i rregulloreve nuk duhet të nënkuptojnë dëmtim të shpejtë të biodiversitetit.
- › Gjatë sjelljes së ndryshimeve në Ligjin për Pyjet, organi legjislativ duhet të marrë parasysh Çështjen e Pyllit Bjaloviezha/Białowieża (Komisioni kundër Polonisë).
- › Investuesi dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, gjatë përgatitjes, përkatësisht miratimit të Studimit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, duhet të kenë parasysh standardet e Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, në radhë të parë nga aspekti i **1) kompletim dhe përditësim i të dhënave të përdorura, 2) ndikimi kumulativ i këtij dhe projekteve të tjera të zbatuara në atë rajon në mjedisin jetësor dhe në zonat e mbrojtura, 3) parimet e një shkalle të lartë mbrojtjeje, kujdesi, parandalimi të përcaktuara në legjislacionin e vendor për mjedisin jetësor dhe 4) pikëpamjet e shkencës.**
- › Publiku duhet të përfshihet në procesin e vendimmarrjes për ndërtimin e autostradës. Mungesa e një vlerësimi në dispozicion të ndikimit në mjedisin jetësor është në kundërshtim me Konventën e Aarhusit.
- › **Realizimi efektiv i projekteve strategjike nuk duhet të nënkuptojë efekt negativ në mjedisin jetësor dhe ekzistencën e pasigurisë ligjore. Republika e Maqedonisë së Veriut duhet të respektojë dokumentet ndërkombëtare në të cilat është nënshkruese, si dhe të drejtën vendore, e cila është e sinkronizuar me BE-në, dhe në këtë mënyrë ka një përgjegjësi të nënkuptuar ndaj BE-së.**

LITERATURA E PËRDORUR

- › European Commission, Forests
- › Pyjet nacionale, Pyjet në RMV
- › Ligji për përcaktimin e interesit publik dhe emërimin e partnerit strategjik për realizimin e projektit për ndërtimin e korridorit infrastrukturor 8 (seksioni: Tetovë - Gostivar - Bukojçan dhe projekti për autostradën Trebenishtë - Strugë – Qafë Thanë) dhe korridori 10 d (seksioni i autostradës Prilep - Manastir) në Republikën e Maqedonisë së Veriut, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 163/2021
- › Propozim Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pyjet
- › Ligji për pyjet, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 64/2009, 24/2011, 53/2011, 25/2013, 79/2013, 147/2013, 43/2014, 160/2014, 33/2015, 44/2015, 44/2015, 15017/147 2016 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 274/2022
- › Plani hapësinor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (2004 – 2020)
- › Njoftimi për synimin për ndërtimin e autostradës A2, pjesa Gostivar – Kërçovë
- › Ministria Federale e Bujqësisë, Pylltarisë, Rajoneve dhe Menaxhimit të Ujërave të Republikës së Austrisë, E Drejta për Pyje – Bashkimi Evropian dhe E Drejta Ndërkombëtare
- › Njoftimi për synimin për përgatitjen e dokumentacionit të projektit në nivel të projektit të infrastrukturës për rrugën shtetërore A2 seksioni Bukojçan-Kërçovë (varianti me tunel)
- › Vendimi nr. 11-2875/2 për përcaktimin e nevojës për vlerësimin e ndikimit në mjedis jetësor
- › Karta e të Drejtave Themelore të Njeriut të Bashkimit Evropian
- › Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë së BE-së, C-441/17, Komisioni kundër Polonisë, 17 prill 2018 (Białowieża)
- › Gjykata e Drejtësisë së BE-së, Raporti i GJDBE-së mbi vendimin në çështjen C-441/17, Komisioni kundër Polonisë
- › Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedisin Jetësor DIRECTIVE 2011/92/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 13 December 2011 on the assessment of the effects of certain public and private projects on the environment
- › Direktiva e BE-së 2011/92
- › Autostrada A2: Seksioni Bukojçan - Kërçovë: Studim i vlerësimit të ndikimit në mjedis jetësor

- › Dekret për përcaktimin e projekteve dhe për kriteret në bazë të të cilave përcaktohet nevoja për zbatimin e procedurës për vlerësimin e ndikimeve në mjedis, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74/2005, 109/2009, 164/2012 dhe 202/2016 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 175/2022
- › Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasje në Drejtësi në Qështjet Mjedisore
- › Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, Analizë e zhvillimit dhe planifikimit të qëndrueshëm të transportit në RSM nga perspektiva e ndikimit në ndryshimet klimatike
- › Ligji për mjedisin jetësor, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/2005; 81/2005; 24/2007; 159/2008; 83/2009; 48/2010; 124/2010; 51/2011; 123/2012; 93/2013; 187/2013; 42/2014; 44/2015; 129/2015; 192/2015; 39/2016 dhe 99/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 89/2022 dhe 171/2022
- › Ligji për planifikim urbanistik, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 111/2023
- › Ligji për Ndërtim, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 111/2023

